



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019

**V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA, POGRADEC**  
**“MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHËRISË”**  
**për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.10.2018 .**

Nga auditimi i ushtruar në Ujësjellës Kanalizime SHA Pogradec mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare, për periudhën objekt auditimi, rezultoi që përse ju përket realizimit të treguesve të performancës (realizimi i të ardhurave), duke vlerësuar nivelin e faturimeve, normën e arkëtimit, humbjet në rrjet, mbulimin me punonjës/lidhje, nivelin e debitorëve, Ujësjellës Kanalizime SHA Pogradec është paraqitur me tregues pozitivë. Përse i përket menaxhimit të shpenzimeve, kryerjes së tyre në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, kanë rezultuar mangësi dhe shkelje në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, gjë e cila është shoqëruar me dëm ekonomik në vlerën 18,903,271 lekë. Si rezultat i mos pasqyrimit të drejtë të veprimeve kontabël, mos likuidimit të detyrimeve të lindura nga marrëveshjet e kredive, pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë drejtë gjendjen financiare të shoqërisë. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në zbatimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave, si dhe në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime SHA Pogradec, sipas programit të auditimit nr 1147/1 prot., datë 18.10.2018, i ndryshuar për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.10.2018 dhe me afat auditimi nga data 22.10.2018 deri me date 28.12.2018 me afat auditimi nga data 22.10.2018 deri më datë 28.12.2018

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## A. OPINIONI I AUDITIMIT

### Baza për Opinionin.

Ne kemi kryer auditimin financiar mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” dhe ISSAI 1700<sup>1</sup> dhe ISSAI 1200<sup>2</sup>, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Ujesjellës Kanalizimeve SHA Pogradec dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ujesjellës Kanalizimeve SHA Pogradec për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve të parashikuara dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

### Opinion i kualifikuar<sup>3</sup>.

Sipas mendimit të KLSH pasqyrat financiare nuk prezantojnë për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

### Baza për konkluzionin/opinionin:

1. Grupi i auditimit shpreh rezerva mbi vlerën e paraqitur në bilanc në lidhje me zërin Inventarët në vlerën 4,883,241,573 lekë, pasi nuk është kryer i saktë procesi i inventarizimit dhe nuk mund të shprehemi mbi vërtetësinë dhe saktësinë e paraqitur të kësaj vlere në

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>3</sup> Opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura. Nga kontrolli i zbatimit të standardeve të auditimit nga Drejtori i Përgjithshëm, u konstatua se në auditimin financiar Ujesjellës Kanalizimet SHA Pogradec, nuk janë kryer të gjitha testet e nevojshme të auditimit sipas pikave të riskut dhe materialitetit, referuar nivelit të sistemeve të kontrollit për vitin 2018, kjo për faktin se pasqyrat financiare deri në momentin e përfundimit të punës në terren nuk ishin mbyllur nga subjekti audituar, nuk plotësojnë kushtet për dhënien e një opinionit për auditimin financiar të pasqyrave të vitit 2018.

bilancin e vitit 2016 dhe 2017.

2. Shoqëria nuk ka llogaritur dhe regjistruar asnjë vlerë në llogarinë Porvigjone duke rënduar periudhën kur kryhen pagesa dhe jo periudhën që i përket shpenzimit në kundërshtim me SNK 37.

3. Rregjistrimi kontabël i shpenzimeve gjyqësore kryhet në momentin e pagesës së vendimit pas marrjes së formës së prerë dhe jo në momentin e zbardhjes së vendimit duke e regjistruar vlerën e tij si detyrim në kundërshtim me SNK 1.

4. Nga auditimi konstatohet se UK SHA Pogradec nuk paguan detyrimet e kredisë 4.88 milion Euro së marrë për projektin “Programi i mbrojtjes së Ambientit Liqeni i Ohrit” marrë me Marrëveshjen e Huasë, Financimit dhe Projektit të datës 23.03.2000 ndërmjet KfW, Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe UK SHA Pogradec si dhe Marrëveshjes së Nënhuasë lidhur midis Ministrisë së Financave dhe UK ShA Pogradec. Me shkresën nr. 7693, datë 19.04.2018 të Sektorit i Startegjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka përcjell detyrimet që rrjedhin nga mos pagesa e kredisë (penalitet) deri në 31.12.2017 është 141,034.25 Euro, vlerë e cila do të rritet me aktrakordimin për vitin 2018. Kjo vlerë përbën penalizimin e shoqërisë.

5. Nga detajimi i llogarisë 468 “Huamarrje Afatgjata në vite” konstatohet se vlera 1,985,398,363.21 lekë për vitin 2017 dhe 1,922,105,404 lekë për vitin 2016 nuk lidhet me gjendjen reale të huave dhe nuk mund të shprehemi se cila është diferenca reale e kësaj llogarie.

Pakësimi i llogarisë 468 “Huamarrje afatgjata në vite” në vitin 2009 me vlerën 1,260,967,067 lekë vlerë e cila ka kaluar në llogarinë 101 “Kapitali” por në vitin 2010 nga kjo llogari dhe është eliminuar kjo vlerë duke sjellë shkelje të SNK 1.

6. Në bilanc është edhe llogaria e grandeve të vite ku teprica e saj në fund të vitit 2017 është 2,288,269,072.11 lekë dhe 2,361,474,791 lekë për vitin 2016, llogari të cilës nuk i dihet origjina dhe cila është burimi i saj. Vet institucionin nga kjo llogari mer 3.5-4.5% në vit në formën e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e amortizimit. Veprim i cili nuk lidhet e as parashikohet në asnjë nga SNK dhe as llogjikën kontabël.

### **Opinionin i auditimit të përputhshmërisë (ISSAI 4000 dhe ISSAI 4400)**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurat të prokurimit të fondeve për periudhën në auditim, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti, Ujësjetës Kanalizime SH.A. Pogradec, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre, por ne disa raste devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar me rezervë”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (jo të përhapura).

### **Baza për opinionin e kualifikuar:**

Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2016 – 31.10.2018 janë kryer gjithsej 5 procedura tenderi me fond limit 31,222,526 lekë dhe 37 procedura blerje me vlera të vogla në vlerën 12,431,142 lekë Grupi i auditimit duke vlerësuar materialitetin dhe riskun në auditim, ka audituar 4 procedura tenderi me vlerë 25,098,206 lekë (procedura e pesë ka filluar brenda periudhës së auditimit por vlerësimi është jashtë kësaj periudhe), ndërsa për procedurat me blerje të vogla 100% të tyre.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ujësjetës Kanalizime SHA Pogradec rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret)

në administrimin e shpenzimeve, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur *nga gabime materiale në vlerë totale 25,533,271 lekë*, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar*.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Ujësjetës Kanalizime SH.A. Pogradec.**

Strukturat drejtuese të subjekti Ujësjetës Kanalizime SH.A. Pogradec, janë përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar në procedurat e prokurimit. Strukturat drejtuese të Ujësjetës Kanalizime SH.A. Pogradec, janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar, ku nga mosbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën *25,533,271 lekë*.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

### **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e strukturave drejtuese të Ujësjetës Kanalizime sha Pogradec dhe punonjësve të saj, ndonëse janë marrë disa masa në lidhje me vendosjen në funksionim të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, rezulton se ligji nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj dhe nuk ka funksionuar në hallkat e njësisë në mënyrë që drejtuesit të bëjnë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Shoqëria UK Pogradec sh.a., nuk ka të përcaktuar misionin, strategjinë dhe objektivat, në hartimin e planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Nëpunësi Autorizues për periudhën e audituar 01.01.2016 deri në 15.02.2016 ka qenë administratori i shoqërisë z. V.G, emëruar nëpunës autorizues me vendim nr. 23, datë 14.10.2015 të Këshillit Mbikëqyrës, ndërkohë që është Asambleja e Përgjithshme, e cila ka kompetencën, si titullar i institucionit për këtë emërim. Nuk është përgatitur "*Deklarata e cilësisë*" dhe Raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, e cili e ka afatin referuar nenit 18 të ligjit për MFK deri në fund të muajit Shkurt të vitit pasardhës, për vitet 2016, 2017, dhe dhjetë mujorin e parë të vitit 2018.

Nuk është përgatitur pyetsori i vetëvlerësimit për vitet 2016, 2017, dhe dhjetë mujorin e parë të vitit 2018 në funksion të realizimit të 5 fushave të kontrollit në të cilat funksionon Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.

UK Pogradec sh.a. nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut. Shoqëria ka bërë hartimin e regjistrit të riskut vetëm për Drejtorinë Ekonomike nr. 64/2 prot. datë 02.02.2017 dhe për Drejtorinë Teknike me nr. 46/1 prot. datë 01.02.2017. Kjo njësi publike nuk ka të miratuar, një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të njësisë publike, bazuar në kërkesat e Kreut III të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Njësia nuk ka të përcaktuara procedura të brendshme të anti korrupsionit dhe të sinjalizimit, ndonëse ajo ka të ngritur njësinë e sinjalizimit me udhër nr. 1 datë 10.01.2018 të nëpunësit autorizues. Për vitin 2016, 2017 dhe 10 mujorin e vitit 2018, nga njësia nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Ujësjeles Kanalizime sha., Pogradec për vitet 2016, 2017 dhe për periudhën nga 01.01.2018 deri në 18.10.2018 nuk ka funksionuar nëpërmjet një rregulloreje të brendshme. Shoqëria ka funksionuar nëpërmjet rregullores së etikës të miratuar me vendim nr. 9, datë 25.03.2015 të Këshillit Mbikëqyrës dhe Rregullores së Brendshme miratuar me vendim nr. 22, datë 18.10.2018 të Këshillit të Administrimit. Në këtë rregullore njësia ka përcaktuar rregulla të brendshme, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Në kundërshtim me kompetencat për titullarin e njësisë, që në këtë rast është Asambleja e Përgjithshme, rregullorja e brendshme e institucionit përcakton se auditi i brendshëm i shoqërisë është nën varësinë e administratorit të shoqërisë. Sa më sipër tregon mosnjohje nga ana e titullarit dhe administrimit të shoqërisë të ligjit nr. 10296, të datës 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe të ligjit nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*. Nga njësia nuk është miratuar Grupi i menaxhimit strategjik (GMS).

Sa më sipër është në kundërshtim Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 *“Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”*. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 16, datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*. Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.07.2010, *“Për miratimin e Manualit për MFK”*. Urdhërit të Ministrit të Financave 108, datë 17.11.2016, *“Për miratimin e Manualit për MFK”*.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 2 faqe 100-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Administrimi i Ujësjeles Kanalizime SH.A. Pogradec për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera me bankë u konstatuan se për disa pagesa mungonin dokumentacioni justifikues i kryerjes së shpenzimit si dhe disa pagesa janë kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, konkretisht:

- Në bazë të faturës nr. 121, datë 04.07.2016 është kryer pagesa prej 89,600 lekë kundrejt Zh.L për blerjen e Drum C220 Bizhub, bashëlidhur praktikës nuk ka asnjë dokument justifikues si dhe blerja është kryer pa procedure prokurimi si dhe mungon lindja e nevojës.

- Bashkëlidhur pagesave të kryera me Tirana Bank datë 17.10.2018 janë kryer likudimet për dy fatura kundrejt Telekom, konkretisht 21,600 lekë dhe 3,543 lekë, bashkëlidhur mungon fatura e Telekom.

- Bazuar në faturën tatimore nr. 8, datë 29.01.2016 (nr. serie 30503108) është kryer pagesa 22,800 lekë ndaj E.B për shërbim konsulence, bashkëlidhur nuk ka dokumentacion për arsyen e kryerjes së kësaj pagese, mënyrën e prokurimit dhe dokumentacion justifikues.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.”

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa që në të ardhmen për çdo shpenzim të kryer me bankë ose arkë të bashkëlidhi të gjithë dokumentat justifikuese origjinale të shpenzimit të kryer me qëllim që të eliminohen shpenzimet të pajustificuara dhe të dokumentohen plotësisht shpenzimet e kryera, si dhe të nxjerri përgjegjësitë për procedurat e mësipërme.

### **Vazhdimisht**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit blerje me vlera të vogla për vitin 2016 u konstatua se janë kryer gjithsej 17 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla nën 100,000 lekë të cilat nuk janë as të parashikuara në regjistrin e parashikimi të blerjeve me vlera të vogla, nuk janë paraqitur në ndryshimet e regjistrin të parashikimit dhe as në regjistrin e realizimit për vitin 2016 dhe 12 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla nën 100,000 lekë për vitin 2017 të cilat nuk janë as të parashikuara në regjistrin e parashikimi të blerjeve me vlera të vogla, nuk janë paraqitur në ndryshimet e regjistrin të parashikimit dhe as në regjistrin e realizimit për vitin 2017 në kundërshtim me pika 3, neni 4 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla dhe përgjegjësia e sektorit të prokurimeve të marrin masa që të hartojnë regjistrin e prokurimit bazuar në kërkesat konkrete dhe gjithë vjetore të të gjitha stukturave të shoqërisë dhe të praqesin çdo ndryshim dhe çdo prokurim në regjistrin përkatës si dhe të eliminojnë praktikën e blerjeve të vogla të paparashikuara.

### **Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla u konstatuan parregullësi si mëposhtë:

- Në 6 raste është përdorur procedura e blerjeve të vogla nën 100,000 lekë për blerjen e pjesëve të makinave (goma + disqe) brenda të njëjtës dite duke shmangur zhvillimin e procedurës elektronike në kundërshtim me nenin 40 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

*“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përlllogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.”*

- Mangësi në lidhje me plotësimin e dokumentacioni të kërkuar për operatorët fitues, konkretisht:

Për procedurën “Blerje letër/kancelari për nevojat e shoqërisë për vitin 2016” u konstatua se në bazë të ftesës për ofertë nr. 8/5, datë 15.04.2016 kërkohet që të gjitha mallrat të kenë

garanci 1 vit nga data e furnizimit gjithashtu bazuar në kontratën nr. ska, datë 19.04.2016, neni 8 “Garancitë”, në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion operatori nuk ka paraqitur asnjë garanci.

Për procedurën ”Blerje pjesë këmbimi për automjetet e shoqërisë me fond limit 656,165 lekë” nga auditimi rezulton se grupi i kolaudimit nuk është shprehur nëse operatori i shpallur fitues ka kryer edhe vendosjen e pjesëve të këmbimit pasi objekti i prokurimit është funizim vendosje. Kjo e bënë të pamundur gjykimin e grupit të auditimit në lidhje me përmbushjen e objektit të prokurimit. Gjithashtu nga ana e Ujësjetllës Kanalizimet ShA Pogradec të gjitha pjesët e këmbimit të hequra nga makinat nuk janë kthyer në magazinë.

Për procedurën ”Blerje pjesë hidraulike” me fond limit 789,975 lekë operatori i shpallur fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në lidhje me origjinën e mallrave.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla dhe përgjegjësia e sektorit të prokurimeve të marrin masa që të bashkërendojnë kërkesat dhe të grupojnë ato në bazë të nevojave dhe qëllimit duke mos tejkaluar limitet ligjore apo shmangur konkurrencën që siguron sistemi elektronik.

**4.2 Rekomandimi:** Komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla dhe grupet e marrjes në dorëzim të mallrave të marrin masa që t’u përmbahen me rigorozitet kritereve të vendosura në ftesën për ofertë duke ruajtur interesat e shoqërisë dhe prokurimin e mallrave me cilësinë e kërkuar.

#### **Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në lidhje me konsumin e karburantit për periudhën objekt auditimi u konstatua se është ngritur grupi i testimit të normave të harxhimit të cilët kanë hartuar procesverbalet përkatëse për cdo automjet në lidhje me normën e harxhimit të karburantit e cila nuk është e dokumentuar, si është matur kjo normë. Nga auditimi u konstatua se procesverbalet e hartuara nga grupi i ngritur nuk mbajnë destinacionin, rrugën që kanë përshkruar me sa litra u nis automjeti dhe sa litra ka gjendje në fund.

Nuk ka një urdhër titullari që të ketë miratuar normativat e harxhimit të karburantit. Nuk ka një firmë titullari për autorizimin e përdorimit të automjeteve.

Fletët e udhëtimit janë të mbajtuara pa kilometrat në fillim të nisjes e deri në fund të udhëtimit, të cilat janë të vendosura në mënyrë subjektive, nga ana e drejtuesit të automjeteve.

Nuk ka firmë të personave udhëtues nën urdhrat e titullarit për përshkrimin e rrugës.

Nuk ka ndonjë kuadrim në fund të muajit mbi litrat e tërhequra dhe sa litra rezultojnë në fund të muajit në serbatorët e automjeteve. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** UK SHA Pogradec të nxjerri përgjegjësitë për situatën e krijuar dhe të marrë masa që në të ardhmen të hartojë procedura të plotë dhe të qarta në lidhje me matjen e normave të harxhimit dhe konsumimit të karburantit sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim shmangien e abuzimeve të mundshme për konsumin e karburantit.

#### **Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyave financiare për vitet 2016 dhe 2017 u konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e SNK, konkretisht:

1. Grupi i auditimit shpreh rezerva mbi vlerën e paraqitur në bilanc në lidhje me zërin Inventarët në vlerën 4,883,241,573 lekë, pasi nuk është kryer i saktë procesi i inventarizimit dhe nuk mund të shprehemi mbi vërtetësinë dhe saktësinë e paraqitur të kësaj vlere në bilancin e vitit 2016.

2. Shoqëria nuk ka llogaritur dhe regjistruar asnjë vlerë në llogarinë Porvigjone duke rënduar periudhën kur kryhen pagesa dhe jo periudhën që i përket shpenzimit në kundërshtim me SNK 37.

3. Rregjistrimi kontabël i shpenzimeve gjyqësore në vlerën 31,400,108 lekë kryhet në momentin e pagesës së vendimit pas marrjes së formës së prerë dhe jo në momentin e zbardhjes së vendimit duke e regjistruar vlerën e tij si detyrim në kundërshtim me SNK 1.

4. Nga auditimi konstatohet se UK SHA Pogradec nuk paguan detyrimet e kredisë 4.88 milion Euro së marrë për projektin “Programi i mbrojtjes së Ambientit Liqeni i Ohrit” marrë me Marrëveshjen e Huasë, Financimit dhe Projektit të datës 23.03.2000 ndërmjet KfW, Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe UK SHA Pogradec si dhe Marrëveshjes së Nënhuasë lidhur midis Ministrisë së Financave dhe UK ShA Pogradec. Me shkresën nr. 7693, datë 19.04.2018 të Sektorit i Startegjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka përcjell detyrimet që rrjedhin nga mos pagesa e kredisë (penalitet) deri në 31.12.2017 është 141,034.25 Euro, vlerë e cila do të rritet me aktrakordimin për vitin 2018. Deri në 31.12.2017 detyrimet për kredinë janë Principal në vlerën 1,219,431.15 Euro, Interes + Komsion angazhimi 234,920.57 Euro, Kamatvonesa (Penalitet) 141,034.25 Euro.

5. Nga detajimi i llogarisë 468 “Huamarrje Afatgjata në vite” konstatohet se vlera 1,985,398,363.21 nuk lidhet me gjendjen reale të huave dhe nuk mund të shprehemi se cila është diferenca reale e kësaj llogarie.

Pakësimi i llogarisë 468 “Huamarrje afatgjata në vite” në vitin 2009 me vlerën 1,260,967,067 lekë vlerë e cila ka kaluar në Llogarinë 101 “Kapitali” por në vitin 2010 nga kjo llogari dhe është eliminuar kjo vlerë duke sjellë shkelje të SNK 1. Kjo problematikë nuk është konstatuar dhe trajtuar nga eksperti kontabël i kontraktuar nga shoqëria. Opinioni i tij ka qenë pozitiv pa asnjë konstatim dhe pa letër për drejtimin.

6. Në bilanc është edhe llogaria e grandeve të vite ku teprica e saj në fund të vitit 2017 është 2,288,269,072.11 lekë, llogari të cilës nuk i dihet origjina dhe cila është burimi i saj. Vet institucionin nga kjo llogari mer 3.5-4.5% në vit në formën e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e amortizimit. Veprim i cili nuk lidhet e as parashikohet në asnjë nga SNK dhe as llogjikën kontabël.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 88-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të analizojë dhe të nxjerri përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në pasqyrat financiare dhe të marrë masa për paraqitjen reale dhe me vërtetësisë të situatës financiare të shoqërisë për nivelet drejtuese dhe publikun në përputhje me SNK .

## **Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës së ekspertit kontabël konstatohet se:

Në bazë të nenit 5 të kontratës nr. 107/7 prot., datë 24.02.2017 me vlerë 1,080,000 lekë:

*“Eksperti Kontabël u bënë të njohur Drejtorisë dhe Këshillit Mbikqyrës problemet e data gjatë auditimit”*

Pjesë integrale e kontratës është edhe programi i hartuar nga ekspertët kontabël.

Në bazë të Programit të Auditimit të Pasqyrave Financiare pika 13, në fund të angazhimit audituesi duhet të përpilojë opinionin e auditimit, raportin e përgjithshëm të auditimit dhe **rekomandimet nëpërmjet Letrës për Drejtimin e entitetit.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstaua se audituesit e pavaur nuk kanë dorëzuar dokumentin Letra për Drejtimin e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 107/7 prot., datë 24.02.2017.



Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr.1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA Nga auditimi i dokumentave të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysish e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të KSH janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar. (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 88-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandime:** Drejtoria e UK SHA Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike të marrë masa që të ndjeki me rigozitet zbatimin e të gjitha neneve të kontratave të lidhura me ekspertë kontabël për auditimin e pasqyrave financiare si dhe të ndjeki hapa konkret në zbatimin e rekomandimeve.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kriterëve të punësimit konstatohet se nuk ka procedura rekrutimi të punonjësve. Nuk bëhet shpallje e vendeve vakante të punës, nuk është përcaktuar niveli i arsimit dhe kriteret shtesë për të gjithë punonjësit e shoqërisë. Veprime në kundërshtim me VKM Nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.” kreu 1, neni 19,20 në të cilat paraqiten qartë kriteret e punësimit të drejtorit teknik dhe atij ekonomik.

(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 5 faqe 136-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, amendimin e Rregullores të Brendshme për procedurat e marrëdhënieve të punës.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Programi ekonomik dhe financiar i Ujësjiellës Kanalizime SH.A. Pogradec nuk është miratuar nga Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë. Drejtoria e shoqërisë nuk ka dërguar një kopje të projektprogramit të zhvillimit ekonomik për vitin 2016 bashkë me relacion shpjegues në ministrinë e linjës administrative, e cila ka kompetencën të monitorojë nevojat për fonde buxhetore në këto shoqëri dhe të programojë miratimin analitik të tyre, në përputhje me mundësitë për financime buxhetore, si edhe nuk ka raportuar pranë prefektit të qarkut. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e VKM në transferimin e aksioneve të shoqërive ujësjiellës kanalizime në njësitë e qeverisjes vendore”, kreu V “Miratimi i programeve të zhvillimit ekonomik të shoqërive” pika 4 dhe pika 5 dhe në kundërshtim me pikën 8 të kreut I të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Kjo ka sjellë mos miratim të programeve nga organet vendimmarrëse të shoqërisë si edhe mungesë monitorimi të nevojave për fonde buxhetore të saj nga AKUK.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Pogradec nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuar nga organet drejtuese të saj. Shoqëria nuk ka hartuar

Plan 5-Vjeçar për Përmirësimin e Performancës dhe Plan të Biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare në Sektorin Ujësjetës – Kanalizime sipas Udhëzuesit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE), ku të përcaktohen: deklarata e vizionit dhe misionit, përmbledhje për drejtuesit e lartë, qëllimet strategjike, analiza dhe parashikimi për menaxhimin e kërkesës për ujë, struktura organizative dhe personeli, programi për përmirësimin e performancës, programi pesëvjeçar për investimet kapitale, buxheti 5-vjeçar për operacionet mirëmbajtjen, nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e VKM në transferimin e aksioneve të shoqërive ujësjetës kanalizime në njësitë e qeverisjes vendore”, kreu V “Miratimi i programeve të zhvillimit ekonomik të shoqërive” pika 2, si edhe në kundërshtim me Udhëzuesin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për Reformën Kombëtare në Sektorin Ujësjetës – Kanalizime.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 4 faqe 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për miratimin në organet e saj vendimmarrëse të programeve ekonomike dhe dërgimin e tyre në instancat kompetente për monitorimin e nevojave për fonde buxhetore.

**9.2 Rekomandimi:** Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Planit 5-Vjeçar për Përmirësimin e Performancës dhe Planit të Biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare në Sektorin Ujësjetës – Kanalizime.

#### ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**10. Gjetje nga auditimi:** Raportimi nga Ujësjetës Kanalizime Pogradec Sh.A. i të dhënave në lidhje me performancën e institucionit paraqitur në treguesit e realizimit të programeve në Këshillin e Administrimit dhe në AKUK, është i pasaktë. Ujësjetës Kanalizime Pogradec Sh.A. ka dërguar ç’do tre mujor në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës kanalizimeve pyetësorët përkatës. Raportimi i të dhënave të prodhimit të ujit paraqitur në këto pyetësorë, nuk përputhet me informacionin ekonomik financiar të përgatitur dhe të paraqitur administrimit nga Departamenti i Financës, përkatësisht për vitet 2017 dhe 2018 janë raportuar në AKUK 85.64 mijë m<sup>3</sup> ujë më pak se janë prodhuar. Ndërsa për vitin 2016 mungon raportimi në AKUK për tre mujorin e dytë të vitit. Ka mospërputhje brenda të njëjtit raportim, të treguesve të realizimit të programeve ekonomik në informacionet ekonomik-financiar të paraqitur Këshillit të Administrimit nga Departamenti i Financës, ku për vitin 2017 në të njëjtin raport paraqiten shifra të ndryshme të shpenzimeve për sigurimet shoqërore një herë në vlerën 11,187,746 lekë dhe një herë në vlerën 7,630,000 lekë. Gjithashtu treguesit e realizimit të programit të vitit 2017, të përdorur si bazë krahasimore në programin ekonomik-financiar të vitit 2018 ndryshojnë nga ato të raportuar në Këshillin e Administrimit, pasi në realizimin e vitit 2017 paraqiten të ardhura në vlerën 269,100,000 lekë, ndërsa në programin e vitit 2018 për krahasim me realizimin e vitit paraardhës paraqiten 278,700,000 lekë të ardhura për vitin 2017. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 12 pika 3, neni 18 pika 7 dhe nenin 20 pika 2 të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 4 faqe 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Departamenti i Financës së UK Pogradec SH.A. të marrë masa në rakordimin me sektorin e ngarkuar për raportimin në AKUK si dhe raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar, të jenë të plotë, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko ekonomik të shoqërisë.

## *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Asamblesë së Përgjithshme e UK SHA Pogradec u konstatuan mangësi në lidhje me:

- 14 prej mbledhjeve të mbajtuara, nuk ka bërë lajmërimin për thirrjen e mbledhjeve të asamblesë ku të jenë të përcaktuara dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 5 dhe 6 të nenit 6 të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 *“Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”*.

- nuk janë përmbushur detyrimet ligjore të lidhjes së kontratave të punës me anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe bazuar në materialet që ju vunë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se vendimi nr. 2, datë 15.02.2016 i Asamblesë së Përgjithshme, për emërimin e Këshillit të Administrimit nuk shoqërohet nga dokumentacioni që vërteton plotësimin e kriterëve nga ana e administratorit dhe anëtarëve të këshillit për të qenë në funksionet e sipërcituara. Kjo ka sjellë mungesë vërtetësie të plotësimin të kriterëve të Administratorit dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit, për tu emëruar në pozicionet e sipërcituara si edhe ushtrimin e funksionit të tyre në mungesë të një kontrate pune. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 12 dhe 18 të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 *“Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”*.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 6 faqe 142-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme e UK Pogradec sh.a. të marrë masa që të bëjë thirrjen e mbledhjeve të saj të paktën 15 ditë përpara mbledhjes, ku të përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës si dhe të bëjë botimin në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore të lajmërimit të mbledhjeve si dhe të gjitha vendimet e marra prej saj të jenë të shoqëruara nga dokumentacioni dhe relacionet përkatëse përshkruese e justifikuese, si edhe të lidhë kontrata pune me Administratorin e shoqërisë dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit të saj.

## *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Këshilli Mbikëqyrës i UK Pogradec SH.A., me vendim nr. 13, datë 09.02.2016 ka miratuar fondin limit prej 5,000,000 lekë për krijimin e faqes së internetit të UK sh.a. Pogradec. Në marrjen e këtij vendimi, të kërkuar me shkresë nr. 74 prot. datë 01.02.2016 të Administratorit të shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës nuk është bazuar në asnjë dokumentacion justifikues lidhur me mënyrën e llogaritjes së fondi, gjithashtu procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë një përmbledhje të asaj se c’ka është thënë në mbledhje. Sa më sipër është në kundërshtim me të drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuara në nenin 19 të Statutit të Shoqërisë, vendim nr. 37, datë 08.10.2015 si edhe në kundërshtim me nenin 16, pika 1, të Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*, ku përcaktohet se *“Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve”*.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 6 faqe 142-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të UK Pogradec sh.a. të marrë masa që të gjitha vendimet e marra prej tij të jenë të shoqëruara nga dokumentacioni dhe relacionet

përkatëse përshkruese e justifikuese, si edhe procesverbalet e mbledhjeve të tij të paraqesin atë çka është thënë në mbledhje.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Këshilli i Administrimit të UK Pogradec SH.A. u konstatuan mangësi në lidhje me:

- nuk ka zhvilluar mbledhje në muajt mars, qershor, korrik dhe shtator 2016, si edhe në muajt shkurt, gusht dhe dhjetor 2017 në kundërshtim me nenin 14, pika 1 të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 .

*1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo më pak se një herë në muaj muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.*

- për 8 mbledhjet e Këshillit të Administrimit të UK Pogradec SH.A. mbajtur në periudhën 15.02.2016 – 31.12.2016 nuk janë bërë njoftimet për thirrjen e mbledhjeve ku të përcaktohen çështjet kryesore dhe rendi i ditës. Për të gjithë periudhën 15.02.2016 – 31.10.2018, Këshilli i Administrimit nuk ka mbajtur një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje. Asnjë nga kopjet e proces-verbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Administrimit nuk janë të vërtetuara nga sekretari i këshillit. Veprime këto në kundërshtim me me nenin 14 pika 4, 5, 6 dhe 7 të Vendimin nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 6 faqe 142-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të UK Pogradec sh.a. të marrë masa që të zhvillojë mbledhje të përmuajshme me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të situatës ekonomiko-financiare të shoqërisë.

### *Në vazhdimësi*

**13.2 Rekomandimi:** Sekretari i Këshillit të Administrimit të UK Pogradec sh.a. të marrë masa që të bëjë njoftimet për thirrjen e mbledhjeve, të mbajë një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje si edhe të vërtetojë proces-verbalet e mbledhjeve.

### *Në vazhdimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatuan mangësi në lidhje me funksionimin e kësaj njësie, konkretisht:

- Njësia e auditimit të brendshëm të UK Pogradec sh.a. përbëhet nga më pak se 3 (tre) punonjës dhe ajo nuk ka funksionuar për një periudhë prej 13 muajsh. Auditimi i brendshëm i UK Pogradec sh.a. është i organizuar në nivel njësie. Struktura e miratuar për këtë njësi për 2016, 2017 dhe 10 mujorin e parë të 2018 është me një punonjës, ndërkohë që ligjërisht duhet të përbëhet nga jo më pak se tre të tillë. Nga vlerësimi i aktivitetit të auditit të brendshëm në Ujësjetellës Kanalizime SH.A. Pogradec, rezultoi se auditimi i brendshëm nuk ka funksionuar për periudhën nga 18.04.2016 deri në 27.09.2016, pasi në këtë pozicion nuk ka qenë i emëruar asnjë punonjës. Ai nuk ka funksionuar për periudhën 11.05.2017 deri në 06.11.2017, pasi punonjësi i emëruar në këtë funksion ka paraqitur raporte shëndetësore për paaftësi të përkohshme, si edhe për periudhën nga 06.11.2017 deri në 22.01.2018 kur është bërë emërimi i punonjëses aktuale të auditit të brendshëm. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 10 pika 1 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe me pikën 3 të vendimit nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

- Emërimet në strukturë në pozicionin e auditit të brendshëm në UK Pogradec sh.a. bërë nga administratorët e shoqërisë, miratimet e planeve strategjike vjetore të auditit të brendshëm, miratimet e programeve të angazhimit në auditim dhe të gjitha miratimet e raporteve të

auditimit bërë nga Administratori i Shoqërisë, si dhe miratimet e Kartës së Auditit të Brendshëm, Kodit të Etikës nga Administratori dhe Këshilli i Administrimit janë kryer në kundërshtim me kompetencat e këtyre të fundit.

Për periudhën e audituar të gjithë emërimet në strukturë në pozicionin e auditit të brendshëm janë bërë nga administratori i shoqërisë, në kundërshtim me parimin e pavarësisë, misionin e auditit të brendshëm, parimet e përgjithshme të funksionimit, organizimin e shërbimit dhe të drejtat e auditit të brendshëm, si dhe ligjit nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, ku specifikohet se përgjegjës për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm janë titullarët e njësive publike. *“Titullari i njësisë në shoqëritë tregtare”* është organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të shoqërisë, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, pra është Asambleja e Përgjithshme. Në këtë kuptim, emërimet në strukturë në pozicionin e auditit të brendshëm, duhet të bëhen nga Asambleja e Përgjithshme. Për periudhën 01.01.2016 – 31.10.2018 të gjithë miratimet e programeve të angazhimit në auditim, si edhe të gjitha raportet e auditimit janë bërë nga Administratori i Shoqërisë dhe më pas i janë nisur për dijeni Këshillit të Administrimit. Titullari i njësisë, si organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Statutin e Ujësllës Kanalizime SH.A. Pogradec nr. 5 datë 14.10.2015 dhe në Ligjin nr.9901 datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, për periudhën 01.01.2016 deri 27.01.2016, si dhe bazuar në Vendimin nr. 63, datë 27.1.2016 për periudhën 27.01.2016 deri 31.10.2018. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”* nenin 12 *“Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive Publike”*, në kundërshtim me nenin 10 pika 2 të ligjit nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, si dhe në kundërshtim me kompetencat e përcaktuara në Vendimin nr. 63, datë 27.1.2016 *“Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”* për Administratorin dhe Këshillin e Administrimit të shoqërisë.

Për pasojë auditit i brendshëm i UK sh.a Pogradec ka funksionuar në kushtet e cënimit të pavarësisë, misionit të auditit të brendshëm, parimet e përgjithshme të funksionimit, organizimit të shërbimit dhe të drejtave.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 2 faqe 100-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme e UK Pogradec sh.a. në cilësinë e titullarit të institucionit, të marrë masa për ngritjen e njësisë së auditit të brendshëm me jo më pak se tre punonjës dhe funksionimin e saj pa ndërprerje ose në bazë të mundësive të lidhet kontratë me një institucion tjetër shtetëror për përmbushjen e misioneve audituese si dhe kryerjen e emërimeve në njësinë e auditit të brendshëm të shoqërisë, si dhe miratimit të programeve të angazhimit në auditim dhe të gjitha miratimet e raporteve të auditimit, miratimit të Planeve Strategjik Vjetor, Kartës së Auditimit dhe Kodit të Etikës.

*Menjëherë*

**14.2 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme e UK Pogradec sh.a. në cilësinë e titullarit të institucionit, të marrë masa që në të ardhmen në pozicionin e audituesit të brendshëm të emërojë persona pa konflikt të interesit dhe emërim në krye të njësisë së auditit të brendshëm të UK Pogradec sh.a. të një punonjësi që plotëson kërkesat ligjore për tu emëruar në këtë pozicion.

*Menjëherë*

**15. Gjetje nga auditimi:** Asambleja me vendimin nr. 6, datë 14.10.2015, vendosi miratimin e 7 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, më konkretisht R.T, A.B, V.G, A.A, R.E, A.M, L.M. Më datë 14.10.2015, Këshilli Mbikëqyrës i “Ujësllës Kanalizime” SHA, Pogradec zhvillon

një mbledhje. Nga shqyrtimi i procesverbalit të kësaj mbledhje evidentohet se Këshilli Mbikëqyrës, pasi zgjedh Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës, propozon rendin e ditës, i cili ndër të tjera parashikonte shkarkimin e administratorit në detyrë z. E.V, si dhe **emërimin e një administratori të ri**, z. V.G. Si përfundim, Këshilli Mbikëqyrës i “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, me Vendimin nr. 23, datë 14.10.2015, vendos emërimin e z. V.G, administratorit të shoqërisë “Ujësjiellës- Kanalizime” SHA Pogradec.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, më datë 14.12.2015, ora 15:00, është zhvilluar mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës të “Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec. Bazuar në Procesverbalin e kësaj mbledhje, pasi u miratua rendi i ditës me përmbajtje të njëjtë me atë të kërkuar nga administratori i “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec, u votuan dhe miratuan të tre pikat e rendit të ditës. Gjatë diskutimeve lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës (*“miratimi i pagës së administratorit”*), propozimi për rritjen e pagës së administratorit (gati dyfishimi i saj) në vlerën 250 000 lekë, arsyetohet nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës *“me rritjen e performancës së Ujësjiellës Kanalizime SHA”*, përmes *“punës së mirë të bërë nga administratori”*. **Procesverbali i kësaj mbledhje është firmosur nga të shtatë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.**

Me Vendimin nr. 39, datë 14.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm”, **ndryshe nga çfarë evidentohet në procesverbalin e mbledhjes**, parashikohet edhe vendosja e një sanksioni në vlerën **50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë (të reja)** për “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec në rast se “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec ndërpret në mënyrë të njëanshme marrëdhënien kontraktore, pa shkaqe të bazuara në ligj dhe është në dëm të interesave ekonomike të shoqërisë paraqet disa shkelje të normave juridike në fuqi.

Pas daljes së këtij Vendimi, Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec dhe administratori në detyrë nënshkruajnë më datë 28.01.2016, një shtesë kontrate me nr. Rep 2791 dhe Kol 1450. Kjo shtesë kontrate parashikon rritjen e pagës së administratorit të shoqërisë duke e përcaktuar pagën në vlerën 250.000 lekë, si dhe detyrimin e “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec për të dëmshpërblyer në vlerën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh administratorin e kësaj shoqërie në rast se “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec ndërpret para përfundimit të afatit kontraktor marrëdhënien kontraktore me të, pa shkaqe të bazuara në ligj. Ndërkohë që sanksioni për administratorin, në rast ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies kontraktore me “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec mbetet i njëjtë: thjesht detyrim për njoftim të punëdhënësit me shkrim, një muaj përpara.

Gjithashtu, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe Statutit të “Ujësjiellës Kanalizime” SHA, Pogradec, nuk është Këshilli Mbikëqyrës dhe aq më tepër një përfaqësues i tij organi kompetent për përcaktimin e pagës së administratorit dhe shpërblimeve shtesë.

Pika “d” e nenit 135 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar, përcakton se është Asambleja e Përgjithshme organi kompetent për miratimin e skemës së shpërblimeve të administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, likuiduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar. Neni 160 i po këtij ligji (referuar për zbatim nga neni 167, paragrafi 5), parashikon se pagat e administratorëve mund të shtohen me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme. Ndërkohë, edhe Statuti i miratuar me Vendimin nr. 5, datë 14.10.2015 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve në pikën “e” të tij parashikon kompetencën e Asamblesë së përgjithshme për miratimin e skemës së shpërblimeve të administratorëve, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar.

Nga tërësia e akteve të vendosura në dispozicion, nuk ka asnjë vendim të Asamblesë së Përgjithshme që përcakton skemën e shpërblimeve për administratorin.

Gjithashtu, mbetet e paqartë se mbi ç'bazë është propozuar dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës rritja (gati dyfishimi) i pagës së Administratorit të shoqërisë, kur nga procesverbali i mbledhje evidentohet se në diskutimet lidhur me këtë çështje nuk është paraqitur asnjë material lidhur me performancën e tij (Administratorit) gjatë kësaj periudhe.

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar parashikon se Këshilli Mbikëqyrës ka cilësinë e organit mbikëqyrës, prandaj Këshilli Mbikëqyrës këqyr vënien në zbatim të politikave tregtare dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin<sup>4</sup>, si rrjedhojë për vetë karakterin që ka ky organ si dhe në mungesë të parashikimeve ligjore dhe statutore, Këshilli Mbikëqyrës nuk e ka kompetencën për të caktuar shpërblim në rast përfundimi në mënyrë të njëanshme të marrëdhënies kontraktore nga “Ujësjetllës Kanalizime” SHA, Pogradec. Këshilli Mbikëqyrës duhet të ushtonte vetëm detyrat e përcaktuara në ligj dhe Statut, dhe këto në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 8 faqe 171-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** Organet vendimmarrëse të UK SHA Pogradec të marrin masa që në të ardhmen të gjitha vendimet e mara ti benë në përputhje me kuadrin ligjor duke rruajtur interesat e ligjshme të Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec si dhe të shfuqizojnë këtë vendim të paligjshëm.

*Vazhdimisht*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në zbatim të programit të auditimit nr.1119 datë 05.11.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në rekomandimet e mëparshme të evaduar në periudhën 3-mujori i fundit i vitit 2015 dhe 9 mujorin e vitit 2016”, janë konstatuar raste të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, konkretisht:

Nga auditimi i ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 800/14, datë 29.12.2015, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 37/2, datë 26.01.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Me urdhrin e Titullarit nr. 27, datë 26.01.2016 “Për zbatimin e planit të veprimit”, është ngritur grupi i punës për analizimin e gjetjeve dhe rekomandimet e KLSH-së, i cili kishte për detyrë të raportonte për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, por pa afat të përcaktuar.

-Nga UK Pogradec nuk është dërguar brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, raportimi mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, e cila përcakton se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

---

<sup>4</sup> Paragrafi i dytë i nenit 166 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 masa organizative, nga të cilat është realizuar plotësisht 3 masa, janë në proces realizimi 9 masa, realizuar pjesërisht 4 masa dhe nuk janë realizuar 4 masa.
- Për shpërblim dëmi janë lënë 21 rekomandime, nga të cilat janë 11 masa janë zbatuar dhe 10 masa nuk janë pranuar.
- Janë rekomanduar 4 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet, konkretisht janë lënë 4 masa disiplinore e përkatësisht; 4 masa “Zgjidhje të kontratës së punësimit” ose “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, masat janë zbatuar pjesërisht. Për 4 punonjës që rezultojnë të larguar nga puna, për të cilët *duhet të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, masa nuk është zbatuar.*

**16.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të UK SHA Pogradec të marrë masa që në të ardhmen të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të KLSH për përmirësimin e situatës brenda afateve të përcaktuara, raportimin sipas detyrimeve ligjore pranë KLSH si dhe marrjen e masave konkrete në rast të refuzimit të zbatimit të këtyre rekomandimeve nga ana e stafit të UK Pogradec SHA.

**Menjëherë dhe Vazhdimitsht**

## **C1. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se UK SHA Pogradec nuk paguan detyrimet e kredisë 4.88 milion Euro së marrë për projektin “Programi i mbrojtjes së Ambientit Liqeni i Ohrit” marrë me Marrëveshjen e Huasë, Financimit dhe Projektit të datës 23.03.2000 ndërmjet KfW, Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe UK SHA Pogradec si dhe Marrëveshjes së Nënhuasë lidhur midis Ministrisë së Financave dhe UK SHA Pogradec. Me shkresën nr. 7693, datë 19.04.2018 të Sektorit i Startegjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka përcjell detyrimet që rrjedhin nga mos pagesa e kredisë (penalitetet) deri në 31.12.2017 është **141,034.25 Euro**, vlerë e cila do të rritet me akt-rakordimin për vitin 2018. Kjo vlerë përbën penalizimin e shoqërisë. Deri në 31.12.2017 detyrimet për kredinë janë Principal në vlerën 1,219,431.15 Euro, Interes + Komision angazhimi 234,920.57 Euro, Kamatvonesa (Penalitet) 141,034.25 Euro. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 88-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e UK SHA Pogradec në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrë masa për sqarimin e situatës dhe të hartojë një skedul për pagesën e gjithë detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e financimit duke minimizuar rrijen e dëmit ekonomik nga penalitetet prej 141,035.25 Euro.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qerasë dhe verifikimit në terren u konstatua se:

3 nga ambientet e marra me qera nuk janë vendosur në funksionim asnjë herë nga UK SHA Pogradec dhe 2 nga këto kontrata janë revokuar, Konkretisht:

- Kontrata e Qerasë Nr. 143 Rep. Nr. 75 Kol. datë 22.01.2016, sipërfaqja 80 m<sup>2</sup>, qeraja mujore 70,000 lekë, afati 12 vjeçar. Kontrata është lidhur midis Qeradhënësit **M.K** dhe Qeramarrësit (UK SHA Pogradec) i përfaqësuar me autorizim F.T.

- Kontrata e Qerasë Nr. 546 Rep. Nr. 473/3 Kol. datë 17.12.2016, sipërfaqja 34.4 m<sup>2</sup>, qeraja mujore 130,000 lekë, afati 12 vjeçar. Kontrata është lidhur midis Qeradhënësit **J.I** dhe Qeramarrësit (UK SHA Pogradec) i përfaqësuar me autorizim F.T.



Për këto dy ambiente deri në revokim të kontratës është paguar qeraja: 1,326,000 lekë + 714,000 lekë = **2,040,000 lekë**.

Deri në fund të periudhës objekt auditimit vazhdon kontrata e qerasë nr. 34 rep., nr. 27/4 kol. datë 22.01.2016, sipërfaqja 53.4 m<sup>2</sup>, qeraja mujore 150,000 lekë, afati 12 vjeçar. Kontrata është lidhur midis Qeradhënësit **F.H** dhe Qeramarrësit (UK SHA Pogradec) i përfaqësuar me autorizim F.T. Për këtë kontratë është paguar qeraja prej **1,800,000 lekë**. Nga verifikimi në terren u konstatua se ambienti është i mbyllur dhe jo në përdorim.

**Në total vlera e qerasë e paguar për ambientet e pa vendosura në funksionim është 3,840,000 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Kontrata e Qerasë Nr. 37 Rep. Nr. 30/1 Kol. datë 22.01.2016, sipërfaqja 36 m<sup>2</sup>, qeraja mujore 120,000 lekë, afati 12 vjeçar. Kontrata është lidhur midis Qeradhënësit B.B dhe Qeramarrësit (UK SHA Pogradec) i përfaqësuar me autorizim F.T.

Në total vlera e qerasë e paguar për këto ambiente është 2,790,000 lekë për periudhën që ato nuk janë vendosur në funksionim.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e UK SHA Pogradec të analizojë shkaqet dhe të nxjerri përgjegjësitë për lidhjen e kontratave të panevojshme për shoqërinë të cilat kanë sjell për pasojë dëm ekonomik për shoqërinë në vlerën 6,630,000 lekë.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera me bankë u konstatuan se për disa pagesa mungonin dokumentacioni justifikues i kryerjes së shpenzimit si dhe disa pagesa janë kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, konkretisht:

- Bazuar në faturën tatimore nr. 331, datë 31.12.2015 është kryer pagesë në vlerën 15,700 lekë ndaj D shpk për pagesë restoranti, bashkë lidhur praktikës nuk ka asnjë dokumentacion justifikues në lidhje me këtë shpenzim.

- Bazuar në faturën tatimore nr. 98, datë 27.01.2016 është kryer pagesa në vlerën 30,000 lekë ndaj XXX group për punë teknike për kontroll gjeneratorësh, pa procedure prokurimi. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Nga Ujësstellës Kanalizme SHA Pogradec, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **45,700 lekë** nga D shpk.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në faturën tatimore nr. 24, datë 12.02.2016 (nr. serie 7914680) është kryer pagesa prej 95,000 lekë për pjesë riparimi automjeti i cili është aksidentuar dhe me siguracion full kasko. Shoqëria e sigurimit e ka riparuar automjetin por sipas përgjegjësit të mjeteve motorike pjesët e vendosura nuk funksionojnë. Pagesa prej **95,000 lekë** përbën dëm ekonomik pasi riparimi duket të mbulohej nga kompania e sigurimit dhe duket të testohet në marrjen në dorëzim nga përgjegjësi i mjeteve motorike. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Nga Ujësstellës Kanalizme SHA Pogradec, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për dëmin ekonomik të shkaktuar dhe të kërkohet arkëtimi i shumës duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 95,000 lekë.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në bazë të faturës nr. 37 (nr. serie 23492138), datë 13.02.2016 është kryer pagesa 96,500 lekë për akomodim hoteli + darkë ndaj M & I shpk. Bashkëlidhur praktikës nuk ka asnjë dokumentacion justifikues të këtij shpenzimi, as për personat për të cilët është kryer ky shpenzim. Pas kërkesës së grupit të auditimit për plotësim praktike u paraqit Vendimi nr. 41, date 21.12.2015 “Miratim Fondi” me anën e të cilit është vendosur miratimi i fondit për pritje të përfaqësuesve të KfW, por edhe ky vendim nuk përbën dokumentacion justifikues shpenzimi. **Vlera 96,500 lekë përbën dëm ekonomik.** (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga Ujësjetllës Kanalizme SHA Pogradec, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për dëmin ekonomik të shkaktuar dhe të kërkohet arkëtimi i shumës duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës “Blerje karburant për nevoja emergjente të shoqërisë (blerje vogël për nevojat e shoqërisë) me fond limit 790,419 lekë” u konstatua se: Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për kryerjen e këtij prokurimi ka realizuar dy bashkëpunime me operatorët “G” shpk dhe me një pike karburanti në pronësi të A.C. Për të dyja këto bashkëpunime operatori ka paraqitur vetëm daklarata bashkëpunimi të cilat nuk janë të hartuara nga noter dhe nuk përmbajë certifikimin e tij. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar me dy standarde duke mos kualifikuar operatorin me ofertë më të ulët sepse nuk kishte pike karburanti maksimalisht 3 km larg Ujësjetllësit. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me LPP dhe i ka shkaktuar UK SHA Pogradec dëmin ekonomik **35,000 lekë** (770,000-735,000). (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga Ujësjetllës Kanalizme SHA Pogradec, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për dëmin ekonomik të shkaktuar dhe të kërkohet arkëtimi i shumës duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës “Blerje e një pompe dhe distributori për shpërndarje naftë nga depozita që ndodhet në territorin e UK SHA Pogradec” nga verifikimi në terren i pompës së naftës nga grupi i auditimit u konstatua që malli nuk përmbush specifikimet e vendosura, vlera **457,500 lekë** për bën dëm ekonomik. (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga Ujësjetllës Kanalizme SHA Pogradec, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për dëmin ekonomik të shkaktuar dhe të kërkohet arkëtimi i shumës duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës ”Blerje Karburant për nevojat e shoqërisë”, u konstatua se KVO e ka vlerësuar gabim dokumentacionin e paraqitur nga operatori X&X ShA dhe e ka skualifikuar me pa të drejtë në kundërshtim me nenin 53 të Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 66 të VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Skualifikimi i gabuar ka sjell për pasojë lidhjen e kontratës me operatorin K Sh.p.k i cili ka ofertë më të lartë (marzh fitimi 9.6%), diferenca e ofertës së paraqitur nga operatori X&X Sh.A (8.69 %) dhe K Sh.p.k. është 0.91% (9.6% - 8.69%) dhe e shprehur në vlerë 38,158.75

lekë pa TVSH dhe 45,790.5 lekë me TVSh, vlerë e cila përben dëm ekonomik. Për sa më sipër mban përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 7 faqe 146-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Nga Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse për dëmin ekonomik të shkaktuar dhe të kërkohet arkëtimi i shumës duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Administrimit të UK Pogradec SH.A. nuk ka zhvilluar mbledhje në muajt mars, qershor, korrik dhe shtator 2016, si edhe në muajt shkurt, gusht dhe dhjetor 2017. Nga verifikimi i listë pagesave të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit për 7 muajt në të cilët ky organ nuk ka zbatuar detyrimin ligjor të ushtrimit të aktivitetit të tij, pasi nuk është mbledhur, rezulton se anëtarët janë paguar rregullisht edhe për këto 7 muaj. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 14, pika 1 të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016

*1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo më pak se një herë në muaj muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.*

Për pasojë shpërblimi i përfituar nga z. R.Sh, anëtar i Këshillit të Administrimit për këtë periudhë (40,000 x 7 muaj) në vlerën 280,000 lekë, shpërblimi i përfituar nga z. L.L anëtar i Këshillit të Administrimit gjatë kësaj periudhe (40,000 x 7 muaj) në vlerën 280,000 lekë si edhe shpërblimi i përfituar nga sekretarja e Këshillit të Administrimit znj. A.C gjatë kësaj periudhe (5,000 x 7 muaj) në vlerën 35,000 lekë, përbëjnë dëm ekonomik për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 6 faqe 142-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1- Rekomandimi:** Drejtoria dhe Departamenti i Financës së UK Pogradec sh.a. të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e dëmit ekonomik prej 595,000 lekë në total, përkatësisht 280,000 lekë të përfituara padrjetësisht nga anëtari i Këshillit të Administrimit z. R.Sh, 280,000 lekë të përfituara padrjetësisht nga anëtari i Këshillit të Administrimit z. L.L dhe 35,000 lekë, shpërblimi i përfituar padrejtësisht nga sekretarja e Këshillit të Administrimit znj. A.C.

*Menjëherë*

## **C2. MASA PËR ELIMIMIN E SHPENZIMEVE JO TË LIGJSHME**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së lidhjes së kontratave të qerasë rezulton se gjatë periudhës objekt auditimi janë lidhur 8 kontrata qeraje. Për studimin e vendodhjes dhe studimin e tregut është ngitur një komision i cili ka hartuar procesverbalet përkatëse nr. 51/1-5 datë 21.01.2016, ku shprehen se: “... rezultoi se pas verifikimit në të gjithë zonën e shërbimit Pogradec i vetmi ambient i përshtatshëm për nevojat e UK SHA Pogradec ... (adresën). Komisioni referuar çmimeve të tregut për marrjen me qera vlerësoi ofertën e dhënë për këtë ambient ..... ”.

Bashkëlidhur akt konstatimeve nuk janë ofertat e marra për këto ambiente si baza e vlerësimit të cmimit të tregut. Nuk ka asnjë arsytim në lidhje me vendndodhjet e zgjedhura si dhe analizë mbi çfarë baze janë vendosur.

Kontratat e lidhura janë me afat 12 vjeçar dhe 3 prej tyre janë shkëputur në mënyrë të njëanshme kontratën nga ana e UK SHA Pogradec pa u vendosur asnjë herë në funksionim.

Nuk është arsyetuar afati 12 vjecar i zgjatjes së kontratave të qerasë, si afat teje i zgjatur dhe kur tregu imobiliar është në zhvillim si dhe prishja e kontratave të qerasë në mënyrë të njëanëshme mund të sjell penalizime të UK SHA Pogradec.

Bazuar në Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 28, datë 30.10.2015 “Për miratim marrje me qera” për të gjitha (tetë) kontratat e qerasë të lidhura midis UK SHA Pogradec dhe subjekteve private rezulton se ato janë lidhur në disfavor të UK SHA Pogradec, pa mendim juridik të sektorit përkatës mbi bazueshmërinë ligjore të sanksioneve të vendosura.

Për kontratat e qerasë janë kryer parapagime në vlerën 42,812,000 lekë dhe drejtimi i shoqërisë nuk ka parë mundësinë e investimit të këtyre shumave për rritjen e treguesve të performancës së shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 3 faqe 108-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e UK SHA Pogradec të analizojë dhe të nxjerri përgjegjësitë për mënyrën e përzgjedhjes së ambienteve të marra me qera dhe të marrë masa që në të ardhmen të ketë shpenzime lidhur me rritjen e performancës si dhe të ngrejë grupe pune që të studiojë situatën reale të çmimeve në treg për qerat si dhe të mire arsyetojë vendodhjen e pikave të zgjedhura.

**1.2 Rekomandimi:** Drejtoria e UK SHA Pogradec dhe Sektori Juridik të marrin masa që në të ardhmen në lidhjen e kontratave të qerasë të shprehen juridikisht duke analizuar çdo nen të kontratës në mbrojtjen e interesave të UK SHA Pogradec.

#### **Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Për procedure e prokurimit “Blerje Karburant për nevojat e shoqërisë për 2 muaj” – negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, me vlerë kontrate 988,000 lekë. Procedurë që nuk është në realizimin e prokurimeve për vitin 2016 konstatohet se:

- Lloji i procedurës të përzgjedhur është në kundërshtim me nenin 33, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi nuk mund të kualifikohet në asnjë nga rastet e parashikuar në ligj, si dhe nuk përmbushen asnjë nga 4 kushtet e përmendura në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nevoja për karburant është një nevojë e parashikuar në fillim të vitit dhe është përgjegjësi e nivelit drejtues marrja e masave konkrete dhe në kohën e duhur për evitimin e situatës së krijuar.

- Kriteret e vendosura janë minimale krahasuar edhe me procedurën e zhvilluar me po të njëjtin objekt por blerje e vogël në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori fitues konstatohet se operatori K nuk ka paraqitur disa nga dokumentat për kualifikim.

- Bazuar në mangësitë në dokumentacion operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar dhe për rrjedhojë procedura duhej anuluar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 7 faqe 146-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandim:** Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masa që të hartojnë dhe zbatojnë kriteret e miratuar për kualifikim duke eliminuar praktika të tilla që sjellin shpenzime jo të ligjshme.

#### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** UK sh.a. Pogradec nuk ka hartuar apo miratuar ndryshim të programit ekonomik-financiar, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të

paparashikuar të cilët për vitin 2016, kanë cuar në rritjen me 164.25% të numrit të punonjësve, krahasuar me programin e miratuar. Për vitin 2016, në program janë parashikuar në mesatare vjetore 85 punonjës për sektorin e ujësjellësit e të kanalizimeve. Numri i strukturës së personelit ka ndryshuar nga muaji në muaji, nga 179 punonjës në muajin shkurt 2016, në 120 punonjës në qershor 2016 dhe me 130 punonjës në dhjetor të 2016. Struktura mesatare vjetore e realizuar për vitin 2016 është 129 punonjës në total dhe ka një tejkallim të programit me 151.76 %, ose 23 punonjës më shumë. Sa më sipër ka sjellë që shpenzimi për pagat e punonjësve të tejkalojë nga 35,000,000 lekë të programuara në 57,500,000 lekë të realizuara, me një tejkallim prej 22,500,000 lekë ose 164.25%. UK sh.a. Pogradec nuk ka hartuar apo miratuar ndryshim të programit ekonomik-financiar, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët kanë cuar në rritjen e konsideueshme të numrit të punonjësve. Kjo ka bërë që shpenzimi për fondin e pagave të ketë një tejkallim prej 22,500,000 lekë dhe shpenzim i rritur në raport me shpenzimet e tjera, të jetë i pamiratuar. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 13, pika 4 dhe nenin 18, pika 7 të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.  
(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 4 faqe 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Departamenti i Financës së UK Pogradec SH.A. të marrë masa që të hartojë e miratojë ndryshime në programet vjetorë ekonomik-financiar shoqëruar me relacion shpjegues, në rast të ngjarjeve që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në momentin e hartimit të programit.

*Në vazhdimësi*

### **C3. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se tek kontrata me nr. 3/10 prot., datë 22.05.2017, të lidhur midis UK Pogradec SHA dhe “A” SHPK, tek neni 5, përcaktohet se afati i sigurimit të shërbimit sipas objektit të kontratës, do të jetë nga muaji Maj 2017 deri në muajin Gusht 2017. Pas këtij afati deri në datën e lidhjes së kontratës së re atë me nr. 753 prot., datë 05.12.2017, UKP SHA, nuk figuron që të ketë në ruajtje objektet e saj ose më saktë, nuk ka asnjë kontratë me ndonjë subjekt që ofron shërbimin e sigurimit të ruajtjes për periudhën Shtator deri Nëntor 2017. Në vazhdim, nga grupi i auditimit, u konstatua një vendim i Gjykatës së Apelit Korçë i cili detyron UKP SHA, ti paguajë paditësit pra shoqërisë “A” SHPK, shumën prej 2,056,420 lekë si detyrim i cili buron nga shërbimi i kryer tek UKP SHA Pogradec, për periudhën 01.09.2017 deri 11.10.2017 sipas faturës tatimore të shitjes së dorëzuar pranë UKP SHA por jo të pranuar nga kjo e fundit, atë me nr. Serie. 59622551, nr. Fature 1021 dhe datë 06.04.2018. Sa më sipër, nuk u konstatua asnjë korespondencë midis UKP SHA dhe operatorit ekonomik “A” SHPK, ku të vihej në dijeni ky i fundit, se kontrata ka përfunduar dhe se nuk mund të vazhdohej më me ofrimin e shërbimit, duke pasur parasysh edhe shkresën me nr. 220 prot., datë 22.08.2017, me anë të së cilës, drejtori i UKP SHA, urdhëron kryerjen e shërbimit të ruajtjes së objekteve të UKP SHA, nga vetë punonjësit e shoqërisë nga data 22.08.2017 e në vazhdim deri në lidhjen e një kontrate të re. UKP SHA, të paktën duhej të njoftonte operatorin ekonomik “A” SHPK, se pas përfundimit të afatit të kontratës me nr. 3/10 prot., datë 22.05.2017, jo vetëm që nuk ka asnjë kontratë në fuqi për ruajtjen e ambienteve nga të tretë por, nga UKP SHA, janë përcaktuar rojet nga stafi i institucionit sipas shkresës me nr. 220 prot., datë 22.08.2017, e si rezultat, ky operator duhej të largohej nga ambientet e UKP

SHA. Sa më sipër, vlera e përcaktuar nga Gjykata e Apelit Korçë, prej 2,056,420 lekë (pa llogaritur shpenzimet shtesë) që i duhet paguar operatorit ekonomik "A" SHPK por që nuk është likuiduar akoma nga UKP SHA, konsiderohet si vlerë me efekt negativ financiar për buxhetin e UKP SHA e cila në rast se do të likuidohet për llogari të operatorit ekonomik "A" SHPK, do të ketë pasojat e një dëmi ekonomik.

*(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 7 faqe 146-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Drejtoria e UKP SHA, të marri masa që në të ardhmen të eliminojë praktika të tilla dhe të njoftojë brenda afateve ligjore operoret ekonomik për përfundimin e mardhenieve kontraktuale, me qëllim shmangjeve të vperimeve ose mosveprimeve të cilat rezultojnë me efekt negativ për buxhetin e shoqërisë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i administrimit të marrëdhënieve të punës ,në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.55 datë 17.12.2015 "Për ngritjen e grupit të specialistëve për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të Ujësjellës Kanalizime në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec", në Vendimin nr.5 datë 19.01.2016 të Asamblesë së Aksionerëve, në vendimin nr.10 datë 31.08.2016 "Ngritjen e grupit të specialistëve për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të UK në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec", Administratori i Ujësjellës Kanalizime ka hartuar Urdhëra për 5 (pesë) "kontrata shërbimi". Nga auditimi i Raportit Përfundimtar "Zgjerimi i Ujësjellës Sh.A Pogradec" date 12.01.2017 konstatohet si më poshtë:

1. Nuk ka relacion mbi specifikat mbi të cilat do të punësohen këta specialiste.
2. Nuk ka shpallje publike për shpalljen e këtyre vendeve vakante.
3. Janë rekrutuar pa konkurse dhe pa mënyrë vlerësimi të tyre.
4. Urdhëri i titullarit është në kundërshtim me Vendimin Nr.55, date 17.12.2015 të Këshillit të Bashkisë Pogradec, pika.2- Ky grup do të përbëhet nga 10(dhjetë) specialistë nga të cilët 5(pesë) propozohen nga Bashkia Pogradec dhe 5(pesë) nga Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Pogradec.

**Vlera 525'150 lekë**, që përbën pagesën e kryer për specialistët për 3 muajt që këta specialistë janë kontraktuar, përbën **efekt financiar negativ** për Ujësjellës Kanalizime SHA Pogradec. *(Më hollësisht trajtuar në Aneksin 5 faqe 136-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **525,150 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me pagesën e kryer për specialistët për 3 muajt që këta specialistë janë kontraktuar, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

**Vazhdimisht**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i administrimit të marrëdhënieve të punës ,në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se bazuar në kërkesën e Drejtorit të Departamentit Ekonomik Z. I.H, Këshilli i Administrimit me Vendimin Nr.18, datë 30.07.2018 "Miratim për disa ndryshime në strukturën organizative të Ujësjellës Kanalizime Sh.A Pogradec", ka miratuar punësimin e 8 (tetë) punonjësve të rinj, me qëllim ngritjen e 4 (katër) grupeve të punës për verifikimin në terren të kontratave të abonenteve. Konstatohet se për këta punonjës :

1. Nuk hartohet listë-prezencë,
2. Nuk ka kohë-shënues.
3. Prezenca e tyre në punë konfirmohet me komunikim telefonik.

4. Nuk ka një orar të përcaktuar pune.
5. Nuk punojnë sipas ditëve zyrtare të punës.

Nga auditimi që u bë për relacionin e datës 01.11.2018 nga Përgjegjësja e Financimeve të Huaja dhe Koordinatorë Projekti Znj. V.S, pasi u bë përlllogaritja e numrit mesatar të procesverbaleve për secilin grup konstatohet se :

- Tre grupet e para, të cilët ishin punonjës të Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Pogradec dhe konkretisht punonjës të grupit të prerjeve kanë bërë mesatarisht 7.12 procesverbale në ditë për person.
- Katër grupet e dyta kanë bërë mesatarisht 10.36 proces verbale në ditë për person.

Duke u nisur nga sa me sipër arsyetohet se punesimi i 8 personave, të cilët u ndanë në 4 grupe me nga 2 veta konstatohet të jetë jo-efektiv, jo-efiçent dhe jo-ekonomik sepse keta të punësuar kanë bërë mesatarisht 3 proces verbale verifikimi më shumë se të punësuarit e grupit të prerjeve të cilët përveç funksionit të tyre, kanë realizuar dhe verifikimin e abonentëve “derë me derë”.

**Vlera 1,680,480 lekë**, që përbën pagesën e kryer për specialistët për 5 muajt që këta punonjës janë kontraktuar, përbën **efekt financiar negativ** për Ujësjetllës Kanalizime SHA Pogradec. (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 5 faqe 136-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,680,480 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me pagesën e kryer për punonjësit për 5 muajt që këta punonjës janë kontraktuar, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me proceset gjyqësore të marrëdhënieve të punës ,në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën 01.01.2016-31.12.2016 janë humbur 3 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **1,168,200 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore; për periudhën 01.01.2017-31.12.2017, janë humbur 24 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **27,339,250.64 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. për periudhën 01.01.2018-30.09.2018, janë humbur 8 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **2,892,568 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **31,400,108.64 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi për buxhetin e shoqërisë.** (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 5 faqe 136-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike e shoqërisë, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

*Menjëherë dhe në Vazhdimësi*

#### **D. PËR BORDIN E MBIKOYRJES PUBLIKE**

Bazuar në gjetjet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të kryer në Ujësjetllës Kanalizime SH.A. Pogradec në lidhje me pasqyrat financiare të audituara nga ekspertët kontabël të autorizuar, kërkohet nga Ju vlerësimin e punës së këtyre ekspertëve për vitet 2016-2018, konkretisht:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës së ekspertit kontabël konstatohet se:

Në bazë të nenit 5 të kontratës nr. 107/7 prot., datë 24.02.2017 me vlerë 1,080,000 lekë:

*“Eksperti Kontabël u bënë të njohur Drejtorisë dhe Këshillit Mbikqyrës problemet e data gjatë auditimit”*

Pjesë integrale e kontratës është edhe programi i hartuar nga ekspertët kontabël.

Në bazë të Programit të Auditimit të Pasqyrave Financiare pika 13, në fund të angazhimit audituesi duhet të përpilojë opinionin e auditimit, raportin e pergjithshëm të auditimit dhe **rekomandimet nëpërmjet Letrës për Drejtimin e entitetit.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit u konstata se audituesit e pavaur nuk kanë dorëzuar dokumentin Letra për Drejtimin e cila përmban rekomandimet për përmirësimin e situatës në kundërshtim me Kontratën nr. 107/7 prot., datë 24.02.2017.

Gjithashtu në bazë të Shtojcës nr.1, Letra e Angazhimit (pjesë integrale e kontratës së shërbimit) audituesit deklarojnë se auditimi dhe puna e kryer prej tyre mbështetet mbi SNA

Nga auditimi i dokumentave të vendosura në dispozicion u konstatua se audituesit e pasqyrave financiare, nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 250 *“Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”*, për arsye se në bazë të gjetjeve të auditimit të KLSH janë konstatuar parregullsi të shumta, si psh në prokurimet publike, në pagesat e kryera në paga. Në raportet e auditimit të sipërcituara, nuk gjejnë vend rezerva në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së transaksioneve dhe llogarive që përbëjnë këto pasqyra financiare, çka nënkupton se auditimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me SNA. Për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë në dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre ekspertët kontabël të autorizuar. (Më hollësisht trajtuar në Aneksin 1 faqe 88-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2016 dhe 2017 u konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e SNK, konkretisht:

1. Grupi i auditimit shpreh rezerva mbi vlerën e paraqitur në bilanc në lidhje me zërin Inventarët në vlerën 4,883,241,573 lekë, pasi nuk është kryer i saktë procesi i inventarizimit dhe nuk mund të shprehemi mbi vërtetësinë dhe saktësinë e paraqitur të kësaj vlere në bilancin e vitit 2016.

2. Shoqëria nuk ka llogaritur dhe regjistruar asnjë vlerë në llogarinë Porvigjone duke rënduar periudhën kur kryhen pagesa dhe jo periudhën që i përket shpenzimit në kundërshtim me SNK 37.

3. Rregjistrimi kontabël i shpenzimeve gjyqësore në vlerën 31,400,108 lekë kryhet në momentin e pagesës së vendimit pas marrjes së formës së prerë dhe jo në momentin e zbardhjes së vendimit duke e regjistruar vlerën e tij si detyrim në kundërshtim me SNK 1.

4. Nga auditimi konstatohet se UK SHA Pogradec nuk paguan detyrimet e kredisë 4.88 milion Euro së marrë për projektin “Programi i mbrojtjes së Ambientit Liqeni i Ohrit” marrë me Marrëveshjen e Huasë, Financimit dhe Projektit të datës 23.03.2000 ndërmjet KfW, Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe UK SHA Pogradec si dhe Marrëveshjes së Nënhuasë lidhur midis Ministrisë së Financave dhe UK ShA Pogradec. Me shkresën nr. 7693, datë 19.04.2018 të Sektorit i Startegjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka përcjell detyrimet që rrjedhin nga mos pagesa e kredisë (penalitet) deri në 31.12.2017 është 141,034.25 Euro, vlerë e cila do të rritet me aktrakordimin për vitin 2018. Deri në 31.12.2017 detyrimet për kredinë janë Principal në vlerën 1,219,431.15 Euro, Interes + Komsion angazhimi 234,920.57 Euro, Kamatvonesa (Penalitet) 141,034.25 Euro.



5. Nga detajimi i llogarisë 468 “Huamarrje Afatgjata në vite” konstatohet se vlera 1,985,398,363.21 nuk lidhet me gjendjen reale të huave dhe nuk mund të shprehemi se cila është diferenca reale e kësaj llogarie.

Pakësimi i llogarisë 468 “Huamarrje afatgjata në vite” në vitin 2009 me vlerën 1,260,967,067 lekë vlerë e cila ka kaluar në Llogarinë 101 “Kapitali” por në vitin 2010 nga kjo llogari dhe është eliminuar kjo vlerë duke sjellë shkelje të SNK 1. Kjo problematikë nuk është konstatuar dhe trajtuar nga eksperti kontabël i kontraktuar nga shoqëria. Opinioni i tij ka qenë pozitiv pa asnjë konstatim dhe pa letër për drejtimin.

6. Në bilanc është edhe llogaria e grandeve të vite ku teprica e saj në fund të vitit 2017 është 2,288,269,072.11 lekë, llogari të cilës nuk i dihet origjina dhe cila është burimi i saj. Vet institucionin nga kjo llogari mer 3.5-4.5% në vit në formën e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e amortizimit. Veprim i cili nuk lidhet e as parashikohet në asnjë nga SNK dhe as llogjikën kontabël.

## **E. MASA DISIPLINORE**

Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Statutin e Ujësjetës Kanalizime Pogradec SHA si dhe në Kontratën Individuale të Punës, nenin 12 “Masa disiplinore” të marrë masat disiplinore si më poshtë:  
“Vëretje” deri në “Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës”, për:

### **1. I.H, me detyrë Drejtor Ekonomik**

Nga auditimi i pasqyave financiare për vitet 2016 dhe 2017 u konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e SNK, konkretisht:

- Grupi i auditimit shpreh rezerva mbi vlerën e paraqitur në bilanc në lidhje me zërin Inventarët në vlerën 4,883,241,573 lekë, pasi nuk është kryer i saktë procesi i inventarizimit dhe nuk mund të shprehemi mbi vërtetësinë dhe saktësinë e paraqitur të kësaj vlere në bilancin e vitit 2016.

- Shoqëria nuk ka llogaritur dhe regjistruar asnjë vlerë në llogarinë Porvigjone duke rënduar periudhën kur kryhen pagesa dhe jo periudhën që i përket shpenzimit në kundërshtim me SNK 37.

- Rregjistrimi kontabël i shpenzimeve gjyqësore në vlerën 31,400,108 lekë kryhet në momentin e pagesës së vendimit pas marrjes së formës së prerë dhe jo në momentin e zbardhjes së vendimit duke e regjistruar vlerën e tij si detyrim në kundërshtim me SNK 1.

- Nga auditimi konstatohet se UK SHA Pogradec nuk paguan detyrimet e kredisë 4.88 milion Euro së marrë për projektin “Programi i mbrojtjes së Ambientit Liqeni i Ohrit” marrë me Marrëveshjen e Huasë, Financimit dhe Projektit të datës 23.03.2000 ndërmjet KfW, Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe UK SHA Pogradec si dhe Marrëveshjes së Nënhuasë lidhur midis Ministrisë së Financave dhe UK ShA Pogradec. Me shkresën nr. 7693, datë 19.04.2018 të Sektorit i Startegjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka përcjell detyrimet që rrjedhin nga mos pagesa e kredisë (penalitet) deri në 31.12.2017 është 141,034.25 Euro, vlerë e cila do të rritet me aktrakordimin për vitin 2018. Deri në 31.12.2017 detyrimet për kredinë janë Principal në vlerën 1,219,431.15 Euro, Interes + Komsion angazhimi 234,920.57 Euro, Kamatvonesa (Penalitet) 141,034.25 Euro.

- Nga detajimi i llogarisë 468 "Huamarrje Afatgjata në vite" konstatohet se vlera 1,985,398,363.21 nuk lidhet me gjendjen reale të huave dhe nuk mund të shprehemi se cila është diferenca reale e kësaj llogarie.

Pakësimi i llogarisë 468 "Huamarrje afatgjata në vite" në vitin 2009 me vlerën 1,260,967,067 lekë vlerë e cila ka kaluar në Llogarinë 101 "Kapitali" por në vitin 2010 nga kjo llogari dhe është eliminuar kjo vlerë duke sjellë shkelje të SNK 1. Kjo problematikë nuk është konstatuar dhe trajtuar nga eksperti kontabël i kontraktuar nga shoqëria. Opinioni i tij ka qenë pozitiv pa asnjë konstatim dhe pa letër për drejtimin.

- Në bilanc është edhe llogaria e grandeve të vite ku teprica e saj në fund të vitit 2017 është 2,288,269,072.11 lekë, llogari të cilës nuk i dihet origjina dhe cila është burimi i saj. Vet institucionin nga kjo llogari mer 3.5-4.5% në vit në formën e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e amortizimit. Veprim i cili nuk lidhet e as parashikohet në asnjë nga SNK dhe as llogjikën kontabël.

## **2. A.B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabiliteti**

Nga auditimi i pasqyave financiare për vitet 2016 dhe 2017 u konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e SNK, konkretisht:

- Grupi i auditimit shpreh rezerva mbi vlerën e paraqitur në bilanc në lidhje me zërin Inventarët në vlerën 4,883,241,573 lekë, pasi nuk është kryer i saktë procesi i inventarizimit dhe nuk mund të shprehemi mbi vërtetësinë dhe saktësinë e paraqitur të kësaj vlere në bilancin e vitit 2016.

- Shoqëria nuk ka llogaritur dhe regjistruar asnjë vlerë në llogarinë Porvigjone duke rënduar periudhën kur kryhen pagesa dhe jo periudhën që i përket shpenzimit në kundërshtim me SNK 37.

- Rregjistrimi kontabël i shpenzimeve gjyqësore në vlerën 31,400,108 lekë kryhet në momentin e pagesës së vendimit pas marrjes së formës së prerë dhe jo në momentin e zbardhjes së vendimit duke e regjistruar vlerën e tij si detyrim në kundërshtim me SNK 1.

- Nga auditimi konstatohet se UK SHA Pogradec nuk paguan detyrimet e kredisë 4.88 milion Euro së marrë për projektin "Programi i mbrojtjes së Ambientit Liqeni i Ohrit" marrë me Marrëveshjen e Huasë, Financimit dhe Projektit të datës 23.03.2000 ndërmjet KfW, Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe UK SHA Pogradec si dhe Marrëveshjes së Nënhuasë lidhur midis Ministrisë së Financave dhe UK ShA Pogradec. Me shkresën nr. 7693, datë 19.04.2018 të Sektorit i Startegjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka përcjell detyrimet që rrjedhin nga mos pagesa e kredisë (penalitet) deri në 31.12.2017 është 141,034.25 Euro, vlerë e cila do të rritet me aktrakordimin për vitin 2018. Deri në 31.12.2017 detyrimet për kredinë janë Principal në vlerën 1,219,431.15 Euro, Interes + Komsion angazhimi 234,920.57 Euro, Kamatvonesa (Penalitet) 141,034.25 Euro.

- Nga detajimi i llogarisë 468 "Huamarrje Afatgjata në vite" konstatohet se vlera 1,985,398,363.21 nuk lidhet me gjendjen reale të huave dhe nuk mund të shprehemi se cila është diferenca reale e kësaj llogarie.

Pakësimi i llogarisë 468 "Huamarrje afatgjata në vite" në vitin 2009 me vlerën 1,260,967,067 lekë vlerë e cila ka kaluar në Llogarinë 101 "Kapitali" por në vitin 2010 nga kjo llogari dhe është eliminuar kjo vlerë duke sjellë shkelje të SNK 1. Kjo problematikë nuk është konstatuar dhe trajtuar nga eksperti kontabël i kontraktuar nga shoqëria. Opinioni i tij ka qenë pozitiv pa asnjë konstatim dhe pa letër për drejtimin.

- Në bilanc është edhe llogaria e grandeve të vite ku teprica e saj në fund të vitit 2017 është 2,288,269,072.11 lekë, llogari të cilës nuk i dihet origjina dhe cila është burimi i saj. Vet institucionin nga kjo llogari mer 3.5-4.5% në vit në formën e të ardhurave për të mbuluar

shpenzimet e amortizimit. Veprim i cili nuk lidhet e as parashikohet në asnjë nga SNK dhe as llogjikën kontabël.

### **3. M.B**

### **4. E.M**

### **5. A.C**

### **6. O.K**

### **7. I.V, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të testimit të tregut për kontratat me qera.**

Nga auditimi i procedurës së lidhjes së kontratave të qerasë rezulton se gjatë periudhës objekt auditimi janë lidhur 8 kontrata qeraje. Për studimin e vendodhjes dhe studimin e tregut është ngitur një komision i cili ka hartuar procesverbalet përkatëse nr. 51/1-5 datë 21.01.2016, ku shprehen se:

“... rezultoi se pas verifikimit në të gjithë zonën e shërbimit Pogradec i vetmi ambient i përshtatshëm për nevojat e UK SHA Pogradec ....(adresën). Komisioni referuar çmimeve të tregut për marrjen me qera vlerësoi ofertën e dhënë për këtë ambient .....”.

Bashkëlidhur akt konstatimeve nuk janë ofertat e marra për këto ambiente si baza e vlerësimit të cmimit të tregur. Nuk ka asnjë arsytim në lidhje me vendndodhjet e zgjedhura dhe analizë mbi cfarë baze janë vendosur.

Kontratat e lidhura janë me afat 12 vjecar dhe 3 prej tyre janë shkëputur në mënyrë të njëanshme kontratën nga ana e UK SHA Pogradec.

### **8. R.F**

### **9. E.M**

### **10. F.T, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se në 6 raste është përdorur procedura e blerjeve të vogla nën 100,000 lekë për blerjen e pjesëve të makinave (goma + disqe) brenda të njëjtës dite duke shmangur zhvillimin e procedurës elektronike në kundërshtim me nenin 40 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

*“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përlogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.*

*Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.”.*

### **11. E.HYKA**

### **12. N.P**

### **13. E.G**

### **14. V.S, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit blerje me vlera të vogla u konstatua se janë gjithsej 17 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla nën 100,000 lekë të cilat nuk janë as të parashikuara në regjistrin e parashikimi të blerjeve me vlera të vogla, nuk janë paraqitur në ndryshimet e regjistrit të parashikimit dhe as në regjistrin e realizimit për vitin 2016 në kundërshtim me pika 3, neni 4 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nga auditimi i procedurës blerje me vlera të vogla u konstuan mangësi në lidhje me plotësimin e dokumentacioni të kërkuar për operatorët fitues, konkretisht:

- Për procedurën “Blerje letër/kancelari për nevojat e shoqërisë për vitin 2016” u konstatua se në bazë të ftesës për ofertë nr. 8/5, datë 15.04.2016 kërkohet që të gjitha mallrat të kenë garanci 1 vit nga data e furnizimit gjithashtu bazuar në kontratën nr. ska, datë 19.04.2016,

neni 8 “Garancitë”, në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion operatori nuk ka paraqitur asnjë garanci.

- Për procedurën ”Blerje pjesë këmbimi për automjetet e shoqërisë me fond limit 656,165 lekë” nga auditimi rezulton se grupi i kolaudimit nuk është shprehur nëse operatori i shpallur fitues ka kryer edhe vendosjen e pjesëve të këmbimit pasi objekti i prokurimit është funizim vendosje. Kjo e bënë të pamundur gjykimin e grupit të auditimit në lidhje me përmbushjen e objektit të prokurimit. Gjithashtu nga ana e Ujësjetës Kanalizimet ShA Pogradec të gjitha pjesët e këmbimit të hequra nga makinat nuk janë kthyer në magazinë.

- Për procedurën ”Blerje pjesë hidraulike” me fond limit 789,975 lekë operatori i shpallur fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në lidhje me origjinën e mallrave

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**

*P.s.1 Ky auditim ka filluar punën audituese ne terren me date 22.10.2018 deri me date 28.12.2018, projekt raporti i auditimit është përcjell me shkrese nr. 1147/4date 25.1.2019, është kthyer përgjigje nga subjekti me date 27.02.2019. Është dhënë mendimi nga Drejtori i Departamentit me date 26.03.2019, nga Drejtori i Sigurimit te Cilësisë dhe Standardeve me date 28.03.2019 dhe është dorëzuar dosja për mendim te Drejtori i Përgjithshëm me date 01.034.2019, se bashku me shume praktika te tjera auditimi.*

*Projekt vendimi është protokolluar ne zyrën e Protokoll Arkivës me date 27.06.2019. Është kaluar për shqyrtim te Kryetari i KLSH me date 08.08.2019.*

*P.s.2 Gjate zhvillimit te këtij auditimi për ish-anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës te Shoqërisë është bere kallëzim penal nr.1147/3, date 22.12.2019 dhe është përcjell ne prokurorin e rrethit Gjyqësor Pogradec.*